



Në bazë të nenit 10 dh 11 lidhur me nenin 14A të Ligjit Nr. 05/L-035 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-224 të Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, rishpallë këtë:

## KONKURS

Prokuroria Themelore në Prishtinë, një (1) pozitë

Referenca : SKPK/PTH/ 14  
Titulli I vendit të pozitës: Shtëpiak  
Pozita: Staf mbështetës, jo shërbyes civil  
Numri i Pozitave: Një (1) pozitë  
Koeficienti: Pesë ( 5 )  
Kohëzgjatja e emërimit: Një (1) vjet me mundësi emërimi pa afat  
Puna Provuese: Tre (3) muaj  
Vendi: Prishtinë

### Qëllimi i vendit të punës:

Mirëmbajtja dhe përkujdesi për objektin, pajimet, pajisjet, orenditë dhe instalimet në institucionin ku punon.

### Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

1. Përgjegjës për mirëmbajtjen e ndërtesës dhe pajimeve, duke përfshirë punët mekanike, elektrike dhe mirëmbajtjet tjera të ngrohjes e të gjeneratorit;
2. Përgjegjës për kontrollimin, identifikimin dhe menjanimin e të gjitha prishjeve mekanike, elektrike dhe të instalimeve, te ujit, të mobileve dhe prishjeve në ndërtesë;
3. Mbanë shënime mbi shpenzimet e karburantit për ngrohje dhe të gjeneratorit,
4. Përgatitë raporte;periodike (ditore, javore, mujore, tremujore dhe vjetore) për llojet e cekura të shpenzimeve;
5. Përgatitë kërkesa për furnizim ose blerje të materialit të nevojshëm duke bërë specifikimin e
6. nevojave, të cilat ia parashtron Administratori I Prokurorisë;
7. Ruan fshehtësinë e punës dhe të dhënave të cilat i dëgjon ose me të cilat ndeshet gjatë punës,
8. Sipas nevojës kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Udhëheqësit.

### Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

- Njohuri të duhura për mbikëqyrje efektive dhe kryerjen e punës së shtëpiakut - mirëmbajtësit;
- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga lëmi mekanikës, elektrikës, ngrohjes
- ventilimit;
- Shkathsi të punës dhe menjimit të prishjeve dhe për punë ekipore;
- I gatshëm të punojë me njerëz të etnive dhe religjioneve të ndryshme;
- Aftësi për ndërmarrjen e iniciativave konkrete gjatë punës dhe lidhur me te;
- Aftësia për ta kryer punën edhe në kushte të punës nën presion;
- Reagimi duhur në zgjidhjen e problemeve.

## **Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:**

- Shkollimi i mesëm dhe trajnime nga fusha përkatëse profesionale.

## **Përvoja e Punës:**

- Së paku 1 vit, përvojë pune në punët e mirëmbajtjes.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në Web faqe zyrtare të Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data e publikimit më **06.09.2018** deri me datë **20.09.2018** si datë e mbylljes së konkursit.

### Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore të të gjitha komuniteteve.

Paraqitja e kërkesave: Formulari për aplikim mund të merret në recepcionin e ndërtesës të Prokurorit të Shtetit adresa: Rruga: "Luan Haradinaj" p.n. apo mund të printohen nga <http://www.kpk-rks.org/> apo <http://www.psh-ks.net/>.

Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 gjer në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati i 7 - të, Zyra Nr. 702, Prishtinë, Kosovë;

Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038 / 200 18874 prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit të kërkuar:

1. Dëshminë e kualifikimit shkollor;
2. Dëshmi mbi përvojën e punës, Vërtetimi ose kontrata e punës;
3. Dy - rekomandime (nëse keni);
4. Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
5. Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
6. Çertifikata nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.

Data e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, do të publikohen vetëm në ueb faqen zyrtare të: Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Institucioni i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe i Prokurorit të Shtetit u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe përkrahë aplikimet e femrave dhe meshkujve të të gjitha komuniteteve të Kosovës.